



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 11, datë 30.12.2021

**PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, KASKADA E HECEVE  
“EGNATIA-SHUSHICË”, HEC GOSTIMË 1, HEC GOSTIMË 2, HEC GOSTIMË 3, HEC  
GOSTIMË 4, HEC GOSTIMË 5, HEC GOSTIMË 5/1, HEC GOSTIMË 6, MBI LUMIN  
GOSTIMË (EGNATIA –SHUSHICË)”, ME VENDNDODHJE NE BASHKITË ELBASAN,  
PËRRENJAS DHE LIBRAZHD, QARKU ELBASAN**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, Kaskada e Heceve “Egnatia-Shushicë”, Hec Gostimë 1, Hec Gostimë 2, Hec Gostimë 3, Hec Gostimë 4, Hec Gostimë 5, Hec Gostimë 5/1, Hec Gostimë 6, mbi lumin Gostimë (Egnatia –Shushicë)”, me vendndodhje në Bashkitë Elbasan, Përrenjas dhe Librazhd, Qarku Elbasan, me subjekt zhvillues shoqërinë “Egnatia Hydropower” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) miratimit të procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkive Elbasan, Përrenjas dhe Librazhd.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**


**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**

